



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN
E MINIERAVE DHE INDUSTRIË

Nr. 8084/1 Prot.

Tiranë, më 16.11.2023

Lënda: Njoftim për fillimin e procedurave për revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr. 949, datë 18.07.2006.

SHOQËRISË "LENA - 1" SH.P.K

Sheshi "Dalip Zhaboli", Objekt privat, Zona kadastrale 2267, Bulqizë, Dibër.

Për dijëni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Blloku "Vasil Shanto", Nr.18, Tiranë.

AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË
MINIERA

Rruga "Lord Bajron", Laprakë, Tiranë.

Shoqëria "LENA - 1" sh.p.k, është zotëruese e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr. 949, datë 18.07.2006, për mineralin krom, në Objektin "Drita e Madhe, Kaptinë, Martanesh", Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër.

Nga struktura përgjegjëse, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, me shkresën Nr. 4758, datë 12.10.2023, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me Nr. 8084, Prot., datë 16.10.2023, është propozuar revokimi i Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr. 949, datë 18.07.2006, për mineralin krom, në Objektin "Drita e Madhe, Kaptinë, Martanesh", Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër, pasi në objekt nuk zhvillohet aktivitet minerar dhe nuk ka miratuar planin vjetor të punës.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, është i mbështetur në Nenin 47, pika 1, gërma "g" të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të Nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, **ju njoftojmë për fillimin e procedurave të revokimit për Lejen Minerare të Shfrytëzimit** Nr. 949, datë 18.07.2006, për mineralin krom, në Objektin "Drita e Madhe, Kaptinë, Martanesh", Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër që shoqëria Juaj zotëron.

Referuar pikës 2, neni 48 "Procedura e revokimit të lejes", keni të drejtë që, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e njoftimit, sipas kushteve të paragrafit të mësipërm, të paraqesni sqarime për shkaqet e përmendura në njoftim për fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare.

Ju bëjmë me dije se, Ministri, do të marrë vendim mbi revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr. 949, datë 18.07.2006, për mineralin krom, në Objektin "Drita e Madhe, Kaptinë, Martanesh", Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër, 30 ditë kalendarike pas kalimit të afatit të përcaktuar në pikën 2, neni 48 "Procedura e revokimit të lejes", të ligjit Nr. 10 304, datë 15.07.2010 "Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

MINISTRI

BELINDA BALLUKU

ME AUTORIZIM

ZËVENDËSMINISTRI

ENKELEJDA MUÇAJ

